

Shprehje interesit dhe përzgjedhjen e përfaqësuesëve në komitetin e programit Horizont 2020 , komitetit ERA (European Research Area Commitees) dhe NCP.

Në zbatim të "Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit European dhe Republikës së Shqipërisë mbi pjesëmarrjen në programin kuadër Horizon 2020 — Programi për Kërkim dhe Inovacion", me synim përthithjen e fondeve për projekte H2020, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka nisur procedurën për përditësimin e:

- 1) Pikave Kombëtare të Kontaktit Horizon 2020 (NCP)
- 2) Të përfaqësuesve në komitetet Horizon 2020
- 3) Të përfaqësuesve në komitetet ERA (European Research Area).

Fushat e hapura për aplikim, funksionet, detyrimet dhe mbështetjen financiare për secilën nga këto fusha lutem i gjeni bashkëngjitur.

I interesuari për të vepruar si përfaqësues në Komitetet e Programit Horizon 2020, Komitet ERA dhe NCP duhet të dërgojë përmes postës e-mail dhe shkresore në AKKSHI brenda periudhës 31 tetor 2018 dokumentet si vijon:

1. Kërkesën për shprehje interesi për të vepruar si përfaqësues i Shqipërisë në Komitetet e Programit Horizon 2020, Komitetet ERA ose NCP.
2. jetëshkrimin e tij/saj sipas formatit Europass,
3. dokumente mbështetëse që provojnë veprimtarinë e tij/saj kërkimore-shkencore, apo eksperiencën në sektorin përkatës,
4. autorizim nga punëdhënësi-sipas shtojcës 3 bashkëlidhur-që i lejon të veprojë si përfaqësues në Komitetet e Programit Horizon 2020, Komitet ERA ose NCP, në kuadër të punësimit të tij në institucionin punëdhënës.
5. autorizim për publikimin e të dhënave të kontaktit

Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikimeve kryhet nga komisioni i veçantë i ngritur nga MASR.

Komisioni, brenda 30 ditëve pas mbylljes së pranimit të kërkesave, bënë vlerësimin e aplikimeve dhe përzgjedh kandidaturat për përfaqësuesit në Komitetet e Programit Horizon 2020, Komitet ERA dhe NCP.

[URDHËR NR. 605 PËR SHPALLJEN PËR SHPREHJE INTERESI](#)

[URDHËR NR. 606 PËR SHPALLJEN PËR SHPREHJE INTERESI](#)

[PROGRAMI HORIZON 2020 , FUSHA E HAPURA PËR APLIKIM](#)